



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 1169 Prot.

Tiranë, më 03.02 2023

Të dhëna mbi vendimin e APP Nr. 04, datë 03.02 2023

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”) në mbështetje të nenit 78/1/b të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (në vijim “LPP”) në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik “Entrust Solutions” Shpk me NUIS L91308005T nga e drejta për të fituar kontrata publike, për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në realizimin e kontratës me objekt: “*Lavazh Automjetesh*” me vlerë 480.240 lekë me Tvsh të lidhur me autoritetin kontraktor, Illyrjan Guard sh.a (në vijim ”AK”).

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit, NIPT, adresa): “Entrust Solutions” Shpk me NUIS L91308005T, me adresë: Rruga “Sulejman Delvina”, Objekti Nr.4, Tiranë.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik “Entrust Solutions” Shpk ka nisur bazuar në kërkesën e AK, i cili me shkresën Nr. 898/11 Prot., datë 14.11.2022, ka kërkuar nga APP përjashtimin e shoqërisë “Entrust Solutions” Shpk, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas parashikimeve të nenit 78/1/b të LPP ku parashikohet se: *“Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: b) mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur përfajtësia e operatorit ekonomik”*.

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 04, datë 03.02 2023, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik “Entrust Solutions” Shpk me NUIS L91308005T, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.